



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12 Korrik 2021

Nr. 424

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ndaj Bashkisë Tiranë
- Kërkues:** Qëndresa Qytetare
- Ndaj:** Bashkisë Tiranë
- Baza Ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administratës së KQZ-së paraqitur gjatë shqyrtimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, në datën 19.03.2021, është raportuar nga organizata “Qëndresa Qytetare” denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2368, ndaj kandidatëve për deputetë të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Billako dhe Bashkisë Tiranë. Denoncuesi pretendon se në shkelje të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020



të Komisionit Rregullator, zj. Skëndo, ditën e enjte në datë 18 Mars, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës, “Misto Treska”, ka zhvilluar takim me mbështetësit në prani të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj. Gjithashtu në datën 11 Mars në ambientet e të njëjtës bibliotekë, kandidati Alqi Bllako, zhvilloi takim me mbështetësit e Partisë Socialiste.

Qëndresa Qytetare denoncon shkeljen e nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, neni 3, pika c, ku në dispozicion të kandidatëve pretendon se janë vendosur asetet e publike konkretisht ambientet e Bibliotekës “Misto Treska”.

Në cilësinë e provës “Qëndresa Qytetare” ka vendosur në dispozicion dy link-e të rrjetit social “Facebook” në të cilin sipas saj, gjenden provat e këtij aktiviteti.

Linku: <https://www.facebook.com/ErionVeliaj/videos/475327973499543>

Linku: <https://www.facebook.com/alqibllako/photos/pcb.249855103500745/249854930167429/>

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, *“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.”*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Lidhur me këtë denoncim të Qëndresës Qytetare, i cili ka si objekt “Shkelje të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet vendosjes së asetëve publike në dispozicion të kandidatëve” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se është objekt shqyrtimi nga ana e tij.



Në këtë denoncim drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, paditësi ka paraqitur dy kërtime, një ndaj kandidatës për deputete zj. Kledina Skëndo dhe Bashkisë Tiranë dhe një ndaj kandidatit për deputet z. Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë, të dyja këto për të njëjtin fakt dhe për të njëjtën shkelje të pretenduar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 65 të Kodit të Procedurave Administrative, ka vendosur shqyrtimin në një gjykim i të dyja kërtimeve dhe nxjerrjen e një vendimi të përbashkët.

Referuar nenit 3, pika 2 e vendimit 9/2020 përcaktohet se cili është rrethi i subjekteve të cilët gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.

Duke qenë se denoncimi lidhet me kandidatët për deputetë zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, konstaton se kandidati për deputet nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi, për shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit.

Kështu zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako nuk janë palë në këtë procedurë administrative.

Referuar po kësaj dispozite, Komisioneri konstaton se Bashkia Tiranë, është subjekti i ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi.

II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3503 prot., datë 09.04.2021, i ka kërkuar, Bashkisë Tiranë informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtyre aktiviteteve, të kandidatëve për deputetë zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës.



Referuar nenit 7, pika 2 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikohet se:

“Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij”.

Kushtëzuar nga afati nënligjor përcaktuar në vendimin nr. 9/2021 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të shtyjë hetimin administrativ deri në një përgjigje të Bashkisë Tiranë për çështjen në fjalë.

Me vendimin nr. 361, datë 19.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Qëndresës Qytetare, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ Bashkisë Tiranë.

Me shkresën nr. 1444/1 prot., datë 14.05.2021, protokolluar me tonën me nr. 5371 prot., datë 19.05.2021, Administratorja e njësisë administrative nr. 10, zj. Karolina Kostallari, bën me dije se në bibliotekën “Misto Treska”, e cila ndodhet në administrimin e kësaj njësie, zhvillon shpesh evenimente dhe aktivitete të karakterit social, kulturor dhe informues për banorët e Njësisë dhe më gjerë, **por në asnjë rast nën menaxhimin dhe monitorimin e tyre nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i karakterit zgjedhor**, kjo dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, Nr. 35, dt. 29.03.2018 “Bibliotekat e lagjeve si qendra multifunksionale”.

III. Analiza ligjore

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

Në kallëzimin e paraqitur nga Qëndresa Qytetare, ajo çka i është vënë në dispozicion KQZ-së për fillimin e procedurës administrative ndaj Bashkisë Tiranë, janë vetëm dy linke në “FB” të cilat Komisioneri i ka konsideruar vetëm si indicie të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 82, pika 1, të KPA-së “Barra e provës” parashikohet se:



“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Përveç dy linkeve në “FB” të vëna në dispozicion bashkë me denoncimin, paditësi nuk ka sjellë asnjë provë tjetër shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij.

Linket në fb të servitura nga Qëndresa Qytetare, formojnë indicje për hetimin administrativ të KQZ-së por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjektit ankues. Ato kurrësesi nuk mund të vlejnë për të treguar vendin e aktivitetit, pjesëmarrësit, llojin e tij, nëse ka qenë për qëllime zgjedhore, kulturore, sociale etj. Për këtë arsye KQZ i ka konsideruar indicje por jo prova në kuptim të KPA-së, që pala të mund të provojë pretendimet e tyre.

Kallëzuesi mundet të paraqesë një indicje për të vënë në lëvizje organin administrativ, por nuk zhvishet nga drejta e tij për të paraqitur prova dhe fakte bindëse, të qarta dhe të plota, pa pasur si qëllim të kalojë barrën e provës te organi administrativ përkatës.

Lidhur me hetimin administrativ të kryer nga KQZ, referuar nenit 77 të Kodit të Procedurave Administrative, pika 1 dhe 2 e tij parashikojnë se:

*“1. Organi publik heton **kryesisht** të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.*

*2. Organi publik përcakton, **në mënyrë të pavarur**, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.”*

Për sa më sipër, për çështjen objekt shqyrtimi, KQZ ka zhvilluar një hetim administrativ, në përmbushje të plotë të nenit 77 të KPA-së.

Referuar nenit 80 të Kodit të Procedurave Administrative *“Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:*

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.



2. *Dispozitat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.”*

Ashtu sikurse kjo dispozitë përcakton, KQZ për këto aktivitete të pretenduara nga kallëzuesi se kanë ndodhur për qëllime zgjedhore në asete publike të vëna në dispozicion nga Bashkia Tiranë kandidatëve Skëndo dhe Bllako, ka mbledhur deklaratën e drejtuesit të institucionit përgjegjës për administrimin e bibliotekës “Misto Treska”, Bashkisë Tiranë, e cila në përgjigjen e kthyer ka mohuar jo vetëm zhvillimin e këtij aktiviteti por dhe të çdo aktiviteti të kryer për qëllime zgjedhore.

Referuar nenit 81 të Kodit të Procedurave administrative parashikohet se *“Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.”*

Në këto kushte, kur kallëzuesi, në mbështetje të detyrimit të tij parashikuar në nenin 82 të KPA-së nuk ka paraqitur asnjë provë, dhe nga hetimi administrativ i zhvilluar nga KQZ, deklaratat e organit përgjegjës kanë qenë në mënyrë kategorike mohuese për zhvillimin e një aktiviteti të tillë në ambientet e Bibliotekës, “Misto Treska” Tiranë, KQZ, në përmbushje të të drejtës së saj parashikuar në nenin 81 të KPA-së për të *çmuar, sipas bindjes së saj, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ*, nuk e ka gjykuar të arsyeshme për të vazhduar më tej me mjetet e tjera të kërkimit të provës.

Provat e faktet e dala nga ky hetim administrativ kurrësesi nuk kanë për qëllim për të provuar ose jo pretendimet e palës paditëse (pasi ky është detyrimi i palës për ta bërë këtë gjë) por për të zbardhur në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme të vërtetën.

Lidhur me sa parashikon neni 3, pika 1.3, shkronja “c” e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator për sa i përket vënies në dispozicion të aseteve të luajshme dhe të paluajshme, duhet që këto asete të vihen në dispozicion **për qëllim zgjedhor**.

Gjithashtu, sipas pikës 2 të po këtij neni, i cili përcakton rrethin e subjekteve të këtij vendimi, kryetari i bashkisë, zëvendësi dhe administrata e tij, e kanë të ndaluar, të drejtojnë të marrin pjesë, apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme **në veprimtari publike** të ndaluara sipas këtij vendimi.



Që të jemi në shkelje të këtyre dy pikave të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative si kushti i “**qëllimit zgjedhor**” ashtu dhe ai i drejtimit, marrjes pjesë, apo kontributit i çfarëdolloj forme i subjektit përkatës **në veprimtari publike**.

Referuar nenit 2, shkronja “b” e vendimit nr 9/2020 të Komisionit Rregullator, “**veprimtari publike, janë të gjitha veprimtaritë, që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën 4 mujore, para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve e publikut rreth tyre.**”

Ashtu sikurse Qëndresa Qytetare na ka vënë në dijeni, këto aktivitete të pretenduara si “zgjedhore” i ka gjetur të postuara në rrjetin social “Facebook”.

Referuar vendimit nr. 04, datë 22.01.2020, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në KQZ, “**Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon pjesëmarrje të medias që ta konsiderojë veprimtarinë publike. Postimi nuk mund të trajtohet si informim.**”

Sa i përket, pjesës së “qëllimit zgjedhor” i analizuar përgjatë këtij vendimi, nuk u arrit të provohej as nga kallëzuesi Qëndresa Qytetare dhe as nga hetimi administrativ i zhvilluar kryesisht nga KQZ.

Në përfundim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku paraqitur nga palët si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, çmon se pretendimi i kallëzuesit, Qëndresa Qytetare, për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator nga ana e Bashkisë Tiranë, nëpërmjet vendosjes së aseteve publike në dispozicion të kandidatëve për deputetë zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Billako, është i pabazuar në prova dhe fakte.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n” dhe pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Bashkisë Tiranë, për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

